



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 160, Datë 29.10.2019

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË HEC-I “KABASH POROCAN” SH.P.K., PËR LËNIEN NË HIPOTEKË DHE BARRË TË ASETEVE NË FAVOR TË BANKËS “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SH.A..

Në mbështetje të nenit 16; nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 6; nenit 7 dhe nenit 8 të “Rregullores për procedurat e transferimit të asetëve nga të licencuarit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr.119, datë 21.07.2016; pikës 1.3 të “Kushteve të Licencës” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.06.2016, gjithashtu dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” dhe pika 3 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2019, mbasi shqyrtoi relacionin nr.98/6 Prot, datë 23.10.2019, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HEC-i “KABASH POROCAN” sh.p.k., për lënien në hipotekë dhe barrë të asetëve në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.,

Konstatohet se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 590 Prot, datë 25.09.2019, shoqëria “HEC-i “KABASH POROCAN” sh.p.k., ka kërkuar lënien në hipotekë dhe barrë të asetëve që disponon në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. për efekt të marrjes së një kredie në vlerë 4 (katër) milion EURO, për financimin e ndërtimit të HEC-eve “Holta Kabash” dhe “Holta Porocan”.
- Kjo shoqëri, është krijuar si detyrim ligjor i nenit 8, pika 1 të Kontratës Koncesionare, Nr. 4581 Rep., Nr. 3418 Kol, datë 06.10.2008, “Për ndërtimin me Koncesion të formës BOT, të HEC-eve “Holta Kabash” dhe “Holta Porocan”, të lidhur ndërmjet shoqërisë “Atlas” sh.a. në cilësinë e Koncesionarit dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, në zbatim të VKM-së Nr. 882, datë 12.12.2007 “Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me koncesion të HEC-eve “Holta Kabash” dhe “Holta Porocan”.
- Shoqëria “HEC-i “KABASH POROCAN” sh.p.k., është mbajtëse e licencës së veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, me nr. 297, Seria PV15K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 94, datë 28.07.2015, për një periudhë 30 vjeçare dhe e licencës së

- veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike, me nr. 298, seria T15, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerve të ERE-s nr. 95, datë 28.07.2015.
- Aplikimi plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për Procedurat e Transferimit të Aseteve nga të Licencuarit si më poshtë:
 - Neni 7 pika 1 gërmat: “a”, “b”, “d”, “h”, janë plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Neni 7 pika 1 gërma “c”, (gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit të asetëve). Plotësuar pjesërisht.
 - Neni 7 pika 1 gërma “e”, (arsyet e kërkesës për kryerjen e transferimit). Shoqëria ka deklaruar se arsyeja kërkesës për miratimin e lënies hipoteke/barrë është financimi i ndërtimit të HEC-eve “Holta Kabash” dhe “Holta Porocan”.
 - Nga të dhënat që disponon ERE, konstatohet se nga raportimi i OSHEE sh.a. rezulton se HEC-et “Holta Kabash” dhe “Holta Porocan” janë në operim, dhe janë të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV. Për vitin 2019 respektivisht kanë prodhuar energji për të gjithë muajt.
 - Neni 7 pika 1 gërma “f”, (efektet e pritshme të transferimit në aktivitetin e të licencuarit). Pa plotësuar.
 - Neni 7 pika 1 gërma “g”, (efekti në furnizimin e rregullt e të qëndrueshëm të klientëve të të licencuarit dhe në tarifat e aktivitetit të licencuar). Pa plotësuar.
 - Neni 7 pika 1 gërma “i”, (Deklaratë me shkrim e personit (Subjektit) tek i cili është propozuar të bëhet transferimi, ku të shpreh gatishmërinë e tij për të garantuar vetë apo me palë të tjera veprimtarinë e licencuar pas kryerjes së transferimit). Pa plotësuar.
 - Neni 7 pika 1 gërma “j”, (Nëse ka patur, listën e transferimeve të kryera më herët nga i njëjti subjekt). Pa plotësuar.
 - Neni 7 pika 3, (Subjektet koncensionare të licencuar, të cilët aplikojnë për miratimin e transferimit të asetëve në ERE, duhet të shprehin në formë të shkruar në marrëveshjen e transferimit të asetëve, detyrimet me të cilat ngarkohen për shkak të marreveshjes së koncensionit e pjesët që transferojnë tek përfituesi. Kjo përfshin edhe informimin e Organit Shtetëror të Autorizuar (MEI) në lidhje me qëllimin e transferimit të asetëve). Plotësuar pjesërisht.
 - Neni 7 pika 4, (Kërkesa, informacioni dhe dokumentacioni i bashkëlidhur kërkesës, duhet të jenë të nënshkruar nga personi ose personat e autorizuar nga shoqëria që kanë kompetencën për përfaqësimin e personit mbajtës licence apo të kandidatit të propozuar). Plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HEC-i KABASH POROCAN” sh.p.k., “Për lënie në hipotekë dhe barrë të asetëve të shoqërisë, në favor të bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a..
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI